



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:131110
Datë: 29.06.2024
Numri i dokumentit: 05876470

CAP.nr.1634/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit A.K. nga Prishtina, me numër personal të cilin e përfaqëson S.K., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër debitorit Qeveria e Kosovës - Ministria e Shëndetësisë - SHSKUK-së - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore, për kompensimin e pagave, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.764/2023, datë 02.10.2023, me datë 21.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit A.K. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.764/2023, i datës 02.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar CPC.nr. 764/2023, të datës 02.10.2023, ka vendosur si në vijim:

“REFUZOHET propozimi për lejimin e përmbarimit të kreditorit A.K., i ushtruar në këtë gjykatë me datë 06.06.2023, sipas dokumentit përmbarues - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, si i pabazuar”.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i kreditorit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit, të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, të lihet në fuqi urdhri përmbarimor dhe të detyrohet debitori që në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj kreditorit shumën si në propozim me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të propozimit për përmbarim e gjer në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet procedurale sipas tarifës së OAK-së dhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbarimore, të gjitha në afat në prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së urdhrimit për përmbarim.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se

Ankesa e autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i kreditorit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 06.06.2023 ka paraqitur propozim për përmbarimin e Vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me numër 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, Vendimit nr. 302/2020, dt. 303/2020 dt. 19.05.2020 dhe Vendimit për korrigjimin e gabimeve nr.01/21-1178, dt. 18.11.2020, me arsye si në propozim,

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të propozimit, ka gjetur se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet ligjore për lejimin e përmbarimit, prandaj me aktvendimin e atakuar CPC.nr.764/2023, datë 02.10.2023, ka vendosur që të refuzohet si i pabazuar propozimi duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se pas shqyrtimit të propozimit për përmbarim dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se propozimi për lejimin e përmbarimit duhet të refuzohet si i pabazuar. Kjo për shkak se dokumenti në bazë të cilit është propozuar që të iniciohet procedura përmbarimore konform nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, tutje referuar si “Ligji për Procedurën Përmbarimore”, edhe pse përbën titull ekzekutiv - dokument përmbarimor, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarim. Në lidhje me këtë, gjykata i është referuar nenit 27,

paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, i cili nën shprehimisht përcakton se “dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të janë treguar kreditori, debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.” Mbi këtë bazë, është e qartë se në mënyrë që një dokument përmbartimor të jetë i përshtatshëm për përmbartim, duhet që në mënyrë kumulative të plotësoj të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe atë pa asnjë përjashtim. Rrjedhimisht, bazuar në kërkesën ligjore të lartpërmendur, dokumenti përmbartues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbartimit në rastin konkret është i pa përshtatshëm për përmbartim. Kjo sepse në dispozitivin e vendimit, përkatësisht dokumentit përmbartimor nuk është përcaktuar shuma të cilën debitori i përmbartimit duhet ta përmbushë ndaj kreditorit të përmbartimit por vetëm në mënyrë të përgjithësuar është obliguar punëdhënësi të bëjë pagesën e kompensimit të dy pagave, pa asnjë specifikim të shumave që duhet kompensuar. Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata, në rastin konkret, konstatoi se dokumenti përmbartimor me të cilin është iniciuar procedura përmbartimore në këtë çështje juridike, konkretisht Vendimi i Inspektoratit të Punës, me të cilin është obliguar debitori që në afat prej tetë (8) ditësh, të bëjë kompensimin e dy pagave bazë në emër të shpërblimit jubilar për punonjësit e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar i Kosovës në Prishtinë megjithëse paraqet dokument përmbartimor, i njëjti, konform nenit 27 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, nuk është i përshtatshëm për përmbartim.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2, pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar është i qartë si në pjesën e dispozitivit dhe atë të arsyetimit dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë edhe arsye të mjaftueshme rreth mënyrës së vendosjes dhe fakteve vendimtare. Një mënyrë e tillë e vendosjes sipas vlerësimit të gjykatës ankimore ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj dhe se aktvendimi i atakuar përmban të gjitha elementet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 160 lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat, përkatësisht faktet e çështjes dhe se aktvendimi i atakuar në këtë rast nuk përmban shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore dhe as zbatim të gabuar të së drejtës materiale, sipas pretendimit ankimor të autorizuarit të kreditorit përmes ankesës së paraqitur.

Pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore pa specifikuar shkeljet e pretenduara, me arsyetimin se në këtë rast dokumenti

i nxjerr në procedurë administrative - vendimi i Inspektoratit të Punës, është dokument i përshtatshëm për përmbardim, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se “ Organi përmbardues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbardimin vetëm në bazë të dokumentit përmbardues dokumentit të besueshëm, po qe se më këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër ”. Në kuptim të kësaj dispozite organi përmbardues duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbardues dhe se arsytimi i gjykatës si në aktvendimit të atakuar në këtë fazë të procedurës, është i drejtë dhe i bazuar për vendosje në këtë çështje, sepse në rastin konkret ka rezultuar se dokumenti është i papërshtatshëm për përmbardim.

Për më tepër, gjykata ankimore vlerësimin për papërshtatshmërinë e dokumentit e mbështet edhe në faktin se dokumenti i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, rezulton të jetë jashtë autorizimeve ligjore nga neni 2 i Ligjit 2002/9, i plotësuar me ligjin Nr. 03/L-017, ku përcaktohen funksionet e Inspektoratit të punës, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës, Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë. Pra, sipas kësaj dispozite, kuptohet se funksioni i Inspektoratit është mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve përkatëse, ndërkaq për kërkesat nga marrëdhënia e punës kompetente për të vendosur është gjykata, - ashtu siç është vlerësuar edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin K027/21, të publikuar me datë 16.12.2022, duke krijuar kështu qartësi se për kërkesat, si në çështjen konkrete të kreditorit, në rast të mos përmbushjes së detyrimeve nga punëdhënësi mund të iniciohet procedurë gjyqësore në kuptim të dispozitave të Ligjit për punë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr. 1634/23, me datë 21.06.2024

Gjyqtarja
Hunaida Pasuli